



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 105, datë 29.07.2020

**PËR
NJOHJEN DHE REGJISTRIMIN ME KUSHT TË SHOQËRISË “VERTEX
SECURITIES” SH.A., PËR TË VEPRUAR VETËM SI AGJENT I SHOQËRISË SË
BROKERIMIT NË TITUJ “WGM SERVICES” LTD.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, si dhe Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Njohjen dhe regjistrimin me kusht të shoqërisë “VERTEX Securities” sh.a., për të vepruar vetëm si agjent i shoqërisë së brokerimit në tituj “WGM Services” Ltd., e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (SySEC), me kusht që:**

Aktiviteti i shoqërisë të fillojë pasi shoqëria të depozitojë në Autoritet brenda një afati kohor prej 1 (një) muaji nga data e miratimit të njohjes së veprimtarisë:

- Kontratën e shoqërisë “VERTEX Securities” sh.a., me shoqërinë e brokerimit në tituj “WGM Services Ltd”, sipas letrës së angazhimit;
- Dokumente që vërtetojnë se ka vendosur një sistem të regjistrimit të telefonatave dhe funksionit të përputhshmërisë;
- Dokumente që vërtetojnë se punonjësit e njësisë që promovon produktet dhe shërbimet e brokerit në titujt dhe komunikojnë me klientët kanë njohuritë e duhura si dhe certifikimet përkatëse sipas kërkesave të kuadrit rregullator ku është licencuar brokeri në titujt, si dhe dokumente që të mos kenë qenë të dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos kenë çështje penale në proces.

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**